

INSTITUTI I AVOKATIT- ROLI I TIJ PËR NJË PROCES GJYQËSOR TË DREJTË DHE TË PAANSHËM

Dr. Juliana LATIFI*

Abstrakt:

Mbrojtja e të drejtave të individit, zhvillimi i një procesi gjyqësor të drejtë dhe të paanshëm, do të mund të sigurohet më mirë nëpërmjet ndihmës juridike, që avokati, si përfaqësues i interesave të ligjshme të individit i siguron atij.

Pavarësia e avokatit është aq e nevojshme për të besuar në procesin e drejtësisë dhe në paanshmërinë e gjyqtarit. Avokatia dhe gjyqësori, në bashkëpunim me njëri-tjetrin, do të sigurojnë standarde dhe respektim të të drejtave të individit në shoqëri.

Reforma në drejtësi kërkon edhe reformim të institutit të avokatisë, ku avokati në ndihmë të gjykatës, me profesionalizëm dhe ndershmëri, duke zbatuar dhe respektuar ligjet në fuqi, si dhe Kodin e Etikës së Avokatit duhet t'i shërbejë dhënies së drejtësisë, dhe forcimit të shtetit ligjor.

Vetëm një institut avokatie i reformuar sipas standardeve ndërkombëtare, do të mund të realizojë një ndihmë ligjore adekuate, dhe të mbështesë gjykatën që të gjykojë me drejtësi.

Fjalët kyç: *Avokatia, gjykatat, individi, reforma e sistemit të drejtësisë, integrimi i Shqipërisë.*

Hyrje

Ky studim, nëpërmjet analizës që i bën institutit të avokatisë, duke e parë atë në lidhje të ngushtë me sistemin gjyqësor, trajton rolin dhe rëndësinë që luan ky institut në sistemin e sotëm të drejtësisë, si dhe nevojën e reformimit të tij në përputhje me standardet e gjithëpranuara ndërkombëtare.¹ Në një këndvështrim historik, studimi prezanton

* Departamenti i së Drejtës Publike dhe Departamenti i së Drejtës Civile; Universiteti Jopublik "Justicia", Fakulteti i Drejtësisë, Tiranë, Shqipëri.

evoluimin e institutit të avokatisë në Shqipëri, duke u ndalur në mënyrë të veçantë në situatën aktuale-raportin e tij me gjykatën dhe me individin.

Nga ana tjetër, nëpërmjet amendimeve të propozuara nga Ministria e Drejtësisë, studimi prezanton edhe nevojën e reformimit të institutit të avokatisë, i cili në koherencë me reformën e sistemit gjyqësor duhet të ecë kah saj. Studimi i referohet legjislacionit aktual, Ligjit nr. 9109, datë 17.07.2003 “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë”, Kodit të Etikës së Avokatit, Statutit të Dhomës Kombëtare të Avokatisë, etj, si dhe akteve ndërkombëtare, në lidhje me standardet që ato vendosin dhe imponojnë në legjislacionin e çdo shteti që dëshiron të anëtarësohet në familjen evropiane.

Mbrojtja e të drejtave të individit, zhvillimi i një procesi gjyqësor të drejtë dhe të paanshëm, përbejnë sot një sfidë për sistemin e drejtësisë në Shqipëri, ku besimi i individit dhe i shoqërisë kundrejt tij është i ulët. Reformimi i sistemit të drejtësisë është i lidhur ngushtë edhe me vendin dhe rolin që duhet të luajë instituti i avokatisë në këtë reformim, për të siguruar një proces gjyqësor të drejtë, ku elementi kryesor për krijimin e besimit të publikut, është bindja se rregullat për të cilat bien dakord në një mënyrë demokratike, zbatohen nga të gjithë dhe pa dallim, qofshin individë apo organizma shtetërorë.

Gjatë dhjetëvjeçarit të fundit, shumica e ndihmës për sistemin e drejtësisë ose projekte të ndryshme janë fokusuar tek gjyqësori dhe arsimimi i gjyqtareve. Krijimi i një tregu funksional për këshillimin ligjor, ku vendim primar e luan instituti i avokatisë është lënë pas dore. Avokatia luan rolin e saj, si në procesin penal-me qëllim garantimin e së drejtës për një gjykim të drejtë, ashtu edhe në procesin civil, kjo duke u bazuar në vetë karakterin që ai prezanton: *Së pari*, gjykata vihet në lëvizje në bazë të kërkesës së palëve². Janë ato që vendosin për fillimin apo pushimin e gjykimit, janë po ata, që përcaktojnë objektin dhe shkakun e padisë. *Së dyti*, gjykimi zhvillohet mbi bazën e provave që palët paraqesin në

¹ Instituti i avokatisë është i organizuar në bazë të Ligjit No. 9109, datë 17.07.2003 “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë”, Kodit të Etikës së Avokatit, si dhe Statutit të Dhomës Kombëtare të Avokatisë.

gjyq dhe vendimi përfundimtar jepet i bazuar në këto prova dhe ligj. Parë në një këndvështrim historik³, instituti i avokatisë në Shqipëri nuk ka ecur në një rrugë të qetë, shpesh atij i është dashur të ndryshojë, duke ju përshtatur vetë sistemit politik në fuqi.

Fillesat e tij, instituti i avokatisë i ka me aktin e parë ligjor të quajtur “Ligje për avokatë”, i cili hyri në fuqi me 30.12.1922 e më pas me krijimin e një legjislacioni modern gjatë kohës së Zogut, ku me 15 qershor 1931 hyri në fuqi akti i ri ligjor “Ligja e Avokatëve”. Ashtu si gjithë legjislacioni i asaj kohe i cili ishte modern për kohën kur u miratua dhe për vetë stadin aktual të zhvillimit ekonomiko-shoqëror që prezantonte Shqipëria “Ligja e avokatëve” sillte një vizion të ri të sistemit avokator në Shqipëri. Por, pas 29 nëntorit të vitit 1944, sistemi politik do të impononte edhe fizionominë e institutit të avokatisë, kështu nëpërmjet Dekretit nr. 217, datë 20.11.1946 “Mbi avokatët”, do të sanksionohej varësia e institutit të avokatisë ndaj pushtetit popullor, ku avokatët kishin për detyrë të ndihmonin organet e pushtetit shtetëror në kryerjen e detyrave të tyre (neni 2).

Ndryshimet në institutin e avokatisë do të vazhdonin⁴, ai si i gjithë sistemi juridik i asaj kohe, duhej të ishte në unison me politikën dhe ideologjinë komuniste, duke respektuar parimet e shtetit socialist. Ndryshimet do të ishin aq drastike, sa do të çonim drejt eliminimit përfundimtar të tij dhe zëvendësimin me të ashtuquajtura “zyra të ndihmës juridike⁵”. Ndryshimet që ndodhën pas viteve '90, kërkuan në kuadër të transformimit të sistemit të drejtësisë edhe vendosjen e këtij instituti, si një e drejtë legjitime që i përkiste si komunitetit të juristëve që ta ushtronte këtë profesion, por edhe si një e drejtë që kishte çdo individ si shtetas i këtij vendi apo person juridik, që të merrte ndihmën e nevojshme ligjore, nëpërmjet avokatit.

Periudha pas viteve '90 dhe aktualisht deri më sot, mund të thuhet së nuk ka qenë e lehtë për zhvillimin e institutit të avokatisë. Ligje të cilat shfuqizojnë njëri-tjetrin si dhe amendime të herë pas hershme të atyre ekzistuese, tregojnë së instituti i avokatisë

vazhdon të jetë akoma i pakonsoliduar, ç'ka e bën atë të dobët dhe problematik në realitetin juridik shqiptar.

Në një rrafsh kohor nga 1990 dhe deri tashme kemi daljen e një sërë ligjesh:

- Ligji nr. 7382, datë 8.05.1990 “Për avokatinë në Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë”
- Ligji nr. 7541, datë 18.12.1991 “Për avokatinë në Republikën e Shqipërisë”
- Ligji nr. 7827, datë 31.05.1994 “Për avokatinë në Republikën e Shqipërisë”
- Ligji nr. 9109, datë 17.07.2003 “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë”

Ky i fundit, i cili është në fuqi pritët që të amendohet, ku Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me Dhomën Kombëtare të Avokatisë: synojnë që *“në kuadër të reformës ligjore që ka përfshirë sistemin e drejtësisë, me qëllim përmirësimin e shërbimeve ndaj qytetarëve dhe dhënien e drejtësisë, dhe në funksionim të krijimit të një kuadri rregullator bashkëkohor për profesionet e lira”*⁶, ta bëjë atë sa më bashkëkohor dhe në funksion të interesave të individit.

Në të shumtën e rasteve palët, si personi fizik-individi dhe/ose personi juridik i drejtohen avokatit për të marrë asistencën e nevojshme profesionale ligjore, që ka të bëjë: me mbledhjen e fakteve/provave; përzgjedhjen dhe seleksionimin e tyre; hartimin e kërkesës/kërkesë-padisë, me bazën dhe shkakun e nevojshëm ligjor; paraqitjen dhe mbrojtjen përpara gjykatës të kërkesës/kërkesë-padisë; si dhe veprime të tjera të nevojshme procedurale.

E drejta për një proces të drejtë dhe të rregull, si një e drejtë themelore e individit, e sanksionuar në Kushtetutën e RSH⁷ (neni 31) dhe në Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut⁸, ku sanksionohet së *“çdo person ka të drejtë për një proces të rregull gjyqësor dhe publik brenda një periudhe kohe të arsyeshme para një gjykatë të pavarur dhe të paanshme të krijuar me ligj”* (neni 6, pika 1), bëjnë të nevojshëm asistencën e avokatit.

Nga ana tjetër, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut⁹, ka theksuar në një sërë vendimesh të saj, së thelbi i një “gjykimi të rregullt” kërkon që: *“një palë në gjykim të ketë mundësi reale për t’ju drejtuar gjykatës dhe një mundësi të barabartë për të paraqitur çështjen e vet. Kjo përfshin të drejtën për t’u përfaqësuar nga një avokat i aftë që mund të merret me çështjet e ndërlukuara ligjore”*. Kuadri ligjor, ku bën pjesë Ligji nr. 9109, datë 17.07.2003 “Për profesionin e avokatit në RSh”, si dhe Kodi i Etikës për Avokatinë, e ngarkojnë avokatin me detyrime të caktuara ligjore por në të njëjtën kohë edhe morale.

Kodi i Etikës, i hartuar sipas standardeve ndërkombëtare¹⁰, me qëllim harmonizimin e legjislacionit shqiptar në atë evropian, sjell parametra të rij në ushtrimin e funksionit të avokatisë. Kështu, avokati, me formimin e tij juridik, duhet të prezantojë përballë klientit të tij, gjykatës, autoriteteve të tjera të drejtësisë, si dhe publikut, një person i cili është i veshur me detyrime morale dhe ligjore, të cilat i lejojnë atij të ushtrojë një profesion të lirë, të pavarur si një mjet themelor për ruajtjen e të drejtave të njeriut përballë fuqisë së shtetit dhe interesave të tjera në shoqëri.

Avokati, pavarësisht se do të jetë mbrojtës i interesave të individit të tij, ai duhet ta mbrojë atë në përputhje, dhe brenda kuadrit ligjor të çështjes. Kodi i Etikës¹¹, sanksionon së avokati duhet të udhëhiqet nga: Parimi i pavarësisë; Parimi i dinjitetit të qenit avokat; Ndërgjegjshmëria dhe kompetenca; Papajtueshmëritë me profesionin e avokatit si dhe konfidencialiteti. Pavarësisht këtyre parimeve të sanksionuara, realiteti flet ndryshe. Jo të pakta janë rastet, kur sjellje jo korrekte të avokatëve madje dhe abuzive, bëhen objekt i opinionit publik, duke diskredituar shumë figurën e tyre, dhe duke u shoqëruar me mos besimin tek sistemi i drejtësisë.

Kërkojmë një sistem gjyqësor të paanshëm, që të jetë në funksion të realizmit dhe zbatimit të ligjit. Në këtë drejtim e rëndësishme është, që të evidentojmë ato probleme që

e cenojnë atë dhe e bëjnë të diskutueshëm si në realitetin shqiptar ashtu edhe në arenën ndërkombëtare, ku në raportet e ndryshme Shqipëria shpesh diskutohet për një “gjqësor” që lë shumë për të dëshiruar dhe larg standardeve të kërkuara.

Në rast se shikojmë sot drejtësinë shqiptare, si avokatia dhe gjyqësori prezantojnë një tablo problematike.

Në rastin e avokatisë, mund të thuhet që:

- Për shkak të nevojës për ndryshime të shpejta, për një profesion i cili nuk ka ekzistuar për shumë vite, avokatia tashmë përballet me një realitet të ri.
- Kuadri ligjor, duke filluar që nga Statuti i Dhomës Kombëtare të Avokatisë dhe Kodi i Etikës së Avokatit, duhet të plotësohet, përshtatet dhe t’i përgjigjet standardeve evropiane.

Por nga ana tjetër, ajo që kërkohet sot nga avokatia është:

1. Dhomat e Avokatisë në rrethe dhe Dhoma Kombëtare e Avokatisë, duhet të shikojnë si nevoje primare, trajnimin e komunitetit të avokatëve, ç’ka është shumë domethënës sot në kuadër të përqasjes së legjislacionit shqiptar me atë të BE-së dhe, dhe në dinamikën e ndryshimeve të vazhdueshme që ndodhin në të.
2. Provimi i dhënies së lejes së ushtrimit të profesionit duhet të bëhet sipas standardeve evropiane, ku e rëndësishme është cilësia e këtyre provimeve.
3. Avokatët duhet të kuptojnë dhe të respektojnë vendin dhe rolin që luajnë në sistemin e drejtësisë, ç’ka do të thotë- së ata që përpiqen të ndërhyjnë në mënyrë të jashtëligjshme në dhënien e vendimeve gjyqësore duhet t’i nënshtrohen një sistemi masash disiplinore deri në ndjekjen penale.
4. Kërkesa e avokatëve për miratimin e akteve të nevojshme nënligjore me qëllim që Shqipëria të arrijë përputhshmëri me rekomandimet e Këshillit të Evropës për profesionin e avokatisë¹².

Problemet në institutin e avokatisë, reflektohen edhe në problematikën që prezanton sistemi gjyqësor, i cili shoqërohet nga:

1. Nevojshmëria e publikimit rregullisht të vendimeve të gjykatave, dhe jo vetëm të vendimeve të Gjykatës së Lartë dhe asaj Kushtetuese.
2. Studimi e ngarkesës së punës së gjykatave, në mënyre që të gjithë gjyqtarët në vend të kenë ngarkesë të ngjashme, por jo te njëjtë.
3. Vendosja e mekanizma të fuqishëm, që dëshmitarët të dëshmojnë dhe të gjithë të pandehurit të dalin në gjyq.
4. Ndarja e çështjeve midis gjyqtareve, në mënyre transparentë dhe me shorte të rregullta me qëllim që të shmangen akuzat për korrupsion.

Dhënia rrugë, zgjidhjes se këtyre problemeve, do të mund te krijoje premisa, qe sistemi i drejtësisë të bëhet i besueshëm dhe bindës, ku në funksion të njëri-tjetrit si gjykata dhe avokatia, do të mund të sigurojnë një bashkëpunim të ndershëm dhe luajal.

Në kuadër të përafrimit të legjislacionit shqiptar me *acquis communautaire*, është shtruar si një çështje e rëndësishme reformimi i sistemit të avokatisë. Aktualisht, pritet që së shpejti instituti i avokatisë i rregulluar me Ligjin nr. 9109, datë 17.07.2003 “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë”, t’i nënshtrohet një reformimi nëpërmjet mendimit te ligjit ekzistues. Duke ju referuar, disa nga amendimeve më të rëndësishme mund të përmendim që ato fokusohen:

- Të lehtësojnë krijimin e zyrave të avokatisë, ku mundësohet krijimi i tyre edhe nga një avokat i vetëm. Ky parashikim i krijon mundësi avokatëve ta ushtrojnë profesionin e tyre, sipas mënyrës së organizimit më të favorshëm për ta, pa ju nënshtuar barrierave të tilla, si ajo e gjetjes së një ortaku.
- Vendosja e një tarife më të ulët për marrjen e licencës për ushtrimin e profesionit të avokatit.

Aktualisht për të marre licencën e ushtrimit të profesionit, kandidati fitues detyrohet ti paguaj Dhomës një tarife në masën 100.000 lekë, që ndërkohë me ndryshimet aktuale të propozuara kjo tarifë do të ketë një vlerë simbolike, atë të shumës së 100 lekëve. Ky ndryshim në vlerë synon, që të shmangë të gjithë pengesat e karakterit ekonomiko-financiar që mund të kenë kandidatët, duke ju siguruar atyre të drejtën për të ushtruar profesionin e avokatit, pavarësisht gjendjes ekonomike.

Përcaktimi i kësaj tarife, është në përputhje edhe me politikat liberalizuese, që kanë ndërmarrë vendet e Evropës në fushën e shërbimeve ligjore ose reduktimit të barrierave të tepërta dhe të panevojshme ligjore, apo ato vetë rregulluese që pengojnë hyrjen në tregun e shërbimeve.

- Në procedimin disiplinor të avokatit.

Aktualisht në ligjin ekzistues, nuk ka funksionuar siç duhet, kjo për shkak të decentralizimit të procedimeve disiplinore në dhomat e avokatisë në rrethe. Me ndryshimet e propozuara, procedimi disiplinor përqendrohet në Dhomën Kombëtare të Avokatisë.

Këtij procedimi disiplinor, do t'i shërbejë edhe një strukturë që do të ngrihet pranë Dhomës Kombëtare të Avokatisë, në fazën e procedimit disiplinor i quajtur “Komisioni i Verifikimit të Ankimit”. Ky komision, do të jetë i përbërë nga avokatë të cilët zgjidhen me short nga lista e avokatëve të dhomave. Për çdo rast nga depozitimi ankesës/kërkesës nga ky komision do të krijohet nënkomisioni i verifikimit të ankimit, si strukturë e posaçme i cila kryen shqyrtimin paraprak të ankesës/kërkesës dhe sipas rastit vendos rrëzimin ose kalimin e saj për gjykim në Komitetin Disiplinor të Dhomë Kombëtare të Avokatisë.

Amendimet e propozuara synojnë edhe një ridimensionim të funksioneve të vetë Komitetit Disiplinor të Dhomë Kombëtare të Avokatisë, duke e përcaktuar këtë organ si përgjegjës për shqyrtimin e kërkesës/ankesës kundër avokatit, në një proces që i garanton atij të drejtën për tu informuar, dëgjuar dhe për t'u mbrojtur në marrjen e masës përkatëse sipas rastit.

- Amendimi tjetër i propozuar, i cili synon në rritjen e performancës së avokatëve gjatë ushtrimit të detyrës, lidhet me të drejtën për tu ankuar ndaj sjelljes dhe veprimeve të avokatëve.

Amendimi sjell zgjerimin e rrethit të subjekteve të cilët mund të depozitojnë një ankesë/kërkesë kundër avokatit, në rastet kur ato shikojnë që avokati shkel dispozita ligjore.

Kjo e drejtë tashme me mendimet e propozuara, i rezervohet edhe organeve drejtuese të dhomave të avokatisë, Ministrisë së Drejtësisë, gjyqtareve dhe prokurorëve apo edhe çdo organi tjetër shtetëror të parashikuar me ligj.

- Një tjetër ndryshim në kuadër të transparencës së veprimtarisë së avokatit, është edhe dhënia e statutit të dokumentit zyrtar, regjistrave të Dhomës Kombëtare të Avokatisë.

Me këtë ndryshim, këto regjistra bëhen subjekt i legjislacionit në fuqi për dokumentet zyrtare, dhe të gjithë të interesuarit gëzojnë të drejtën e informimit lidhur me këto regjistra.

Mund të thuhet, së të gjithë këto ndryshime në reformimin e sistemit të avokatisë, synojnë rritjen e performancës së veprimtarisë së tij, si aktor i rëndësishëm në realizimin e dhënies së drejtësisë.

Konkluzione

- Një sistem drejtësie mund të reformohet vetëm në një bashkëpunim të të gjithë aktorëve të tij, ku një rol të rëndësishëm luan edhe instituti i avokatisë, ku “Pavarësia e avokatit siguron paanësinë e gjyqtarit”.
- Amendimi i ligjit ekzistues nr. 9109, datë 17.07.2003 “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë duhet të shoqërohet edhe me nxjerrjen e akteve të nevojshme nënligjore me qëllim që Shqipëria të arrijë përputhshmëri me rekomandimet e Këshillit të Evropës për profesionin e avokatisë.
- Avokatët duhet të kuptojnë dhe të respektojnë vendin dhe rolin që luajnë në sistemin e drejtësisë. Çdo ndërhyrje e tyre në mënyrë të jashtëligjshme në dhënien e vendimeve gjyqësore, duhet të shoqërohet me procedim disiplinor deri në ndjekje penale.
- Profesionalizmi, ndërgjegjshmëria, ndershmëria dhe kompetenca duhet të karakterizojnë çdo avokat në punën e tij, për të siguruar realizimin e një gjykimi të drejtë dhe të paanshëm në mbrojtje të shtetit ligjor.

Bibliografia

1. Kodi i Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë
2. Petraq Curi. E drejta avokatore shqiptare. Botimet “Dita 2000”, faqe 16-33
3. Dekret Ligji nr. 1143, datë 11.09.1950; Dekreti nr. 1601, datë 8.01.1953 “Mbi avokatinë” ndryshuar me ligjin nr. 3350, datë 03.10.1961.
4. Dekreti nr. 4277, datë 20.06.1967 “Mbi avokatinë”
5. Relacion i Ministrisë së Drejtësisë “Për projekt-ligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9109, datë 17.02.2003 “Për profesionin e avokatit në RSh” i ndryshuar”.
6. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë
7. Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut
8. OSCE Albania- Analiza e sistemit ligjor në Shqipëri, 2004
9. UN Basic Principles on the Role of Lawyers (1990)
IBA- General principles for the legal profession – Adopted by the International Bar Association on September 2006
10. Kodi i Etikës së Avokatit
11. Mediation of Civil Matters.Recommendation 2002/10 adopted by the Committee of Ministers of the Council of Europe of 18 September 2002
Directive 98/5/ EEC 16 February 1998 to facilitate practice of the profession of lawyer on a permanent basis in a Member State other than that in which the qualification was obtained.